



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.25

Prishtinë, më 12.11.2015 ora: 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi dhe Alma Lama.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Jelena Bontic dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: Ministrisë së Administratës Publike, OSCE, KDI, ZPRK, RTV21.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;

Sadri Ferati – kryesues i Grupit punues, njoftoi komisionin se në punëtorinë dy ditore kanë shqyrtuar në tërësi P/ligjin dhe kanë hartuar propozim ndryshimet të cilat i prezantoi si në vijim:

Neni 2 paragrafi 1.3. Mbetet teksti si në P/ligj.

Neni 2 paragrafi 3 ndryshohet si vijon: Parimet e përgjithshme të përcaktuara në këtë Ligj, zbatohen për analogji dhe me ndryshimet e nevojshme (në vijim “përshtatshmërisht”) edhe kur një organ publik vepron sipas të drejtës private.

Neni 4 paragrafi 1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda (fshihen fjalët kufijve të) kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.

Neni 4 paragrafi 3.2. mbetet teksti si në P/ligj.

Neni 4 paragrafi 4. në tërë tekstin e P/ligjit fshihen fjalët “**apo diskrecioni**”.

Neni 7 paragrafi 1. Mbetet teksti si në projektligj.

Neni 8 paragrafi 1. Mbetet teksti si në projektligj.

Neni 9.3. Reformulohet si vijon: Të drejtat e parashikuara nga ky nen, kufizohen me ligj, kur është e domosdoshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të te dhënave personale apo të dhënave afariste e profesionale, të mbrojtura sipas ligjit.

Neni 10. Paragrafi 2. Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për te dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative.

Neni 11 paragrafi 1. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure.

Neni 11 paragrafi 2. Organi publik, gjatë procedurës administrative, ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridik të personave të tjerë. Fshihen fjalët “dhe interesin publik”.

Neni 15, paragrafi 1, ndryshohet si vijon: “Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Ligj, zotësia për te vepruar e një personi fizik apo juridik, në procedurën administrative, percaktohet sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit civil”.

Neni 15 paragrafi 3. Organi publik, palë në një procedurë administrative, vepron nëpërmjet titullarit të tij, përfaqësuesi ligjor apo të autorizuar” të caktuar sipas ligjit.

Neni 16. Paragrafi 2. Në rastet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëse është urgjente dhe nëse e kërkon interesi i palës, organi publik i cakton, sipas detyrës zyrtare, një

përfaqësues të përkohshëm, për kryerjen e një veprimi të caktuar procedural ose deri në caktimin apo zëvendësimin e përfaqësuesit ligjor.

Neni 17 paragrafi 1. Pala mund të autorizojë një përfaqësues, që të veprojë në emër dhe për llogari të saj, për të gjithë procedurën administrative apo vetëm për kryerjen e një veprimi të caktuar procedural, përveç rastit kur me ligj kërkohet që vetë pala personalisht të kryejë një veprim të caktuar procedural.

Komisioni nuk ka vendosur se cili propozim si në vijim duhet të mbetet?

Propozimi I - Neni 17 paragrafi 4. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Ligj, lidhur me përfaqësuesin e autorizuar në procedurën administrative, zbatohen, **për aq sa është e mundur**, dispozitat përkatëse të legjislacionit civil.

Propozimi i II – riformulim:

Neni 17 paragrafi 4. ndryshohet si vijon: ”Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Ligj, dispozitat përkatëse të legjislacionit civil mbi përfaqësimin, zbatohen, përshtatshmërisht në procedurën administrative”.

Neni 18.1. Tek teksti i P/ligjit në gj. angleze referenca ndryshohet sipas nenit 17.

Neni 19.2. “Përveç sa përcaktohet” ndryshohet **“Përveçse, siç përcaktohet”** vazhdon teksti.

Neni 20.4. Kur përfaqësuesi i autorizuar jep një deklaratë me gojë, pala e pranishme, mund ta zhvlerësojë apo tërheqë atë, aty për aty.

Neni 23 paragrafi 2. Nëse një organ publik ka filluar një procedurë administrative pa pasur kompetencën e nevojshme dhe me vonë i është dhënë kjo kompetencë sipas ligjit, ai do të vlerësohet kompetent që nga fillimi.

Neni 24 paragrafi 1. Nëse një organ publik kompetent nuk mund të veprojë, **ose** të veprojë pa vonesë, për shmangien e një dëmi të menjëhershëm, të rëndë dhe të pariparueshëm që mund t’i shkaktohet interesit publik apo të drejtave a interesave juridike të personave, çdo organ tjetër publik, **sipas detyrës zyrtare** apo me kërkesë, është kompetent të ndër marrë veprimet të domosdoshme për shmangien apo kufizimin aty për aty të dëmit.

Neni 29, paragrafi 1.1. riformulohet si vijon: ”kur me palën, me përfaqësuesin ligjor apo me të autorizuarin e palës, është në gjini të gjakut në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë, kurse në vijë të tërthortë deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort apo në gjini të krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo”;

Neni 33 paragrafi 3.1. të këshillojë aplikantin, njësoj siç detyrohet të bëjë organi publik kompetent dhe t’i sigurojë atij informimin dhe ndihmën aktive sipas nenit 11 të këtij Ligj. Kjo përfshinë edhe informatat për mjetet dhe kushtet për qasjen në regjistrat publikë dhe në bazat e të dhënave shtetërore, si dhe për mjetet juridike. Fshihen fjalët **”në rast mosmarrëveshjeje”**.

Neni 33 paragrafi 8. Dispozitat e paragrafit 1 deri 7 të këtij neni zbatohen përshtatshmërisht edhe në këtë rast.

Komisioni shqyrtoi të gjitha propozim ndryshimet deri në nenin 40 të tekstit të P/ligjit dhe caktojë mbledhjen e radhës për dt 23.11.2015 për të vazhduar me shqyrtimin e propozimeve për nenet e tjera.

3. Të ndryshme.

Pasi për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime, mbledhja përfundoi.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:00.

E përgatiti :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Zenun Pajaziti**
